



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:203527
Datë: 22.03.2024
Numri i dokumentit: 05489279

Rev.nr.101/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar, Millena Gjeriq, dhe Rustem Thaqi, anëtarë, në çështjen kontestimore të paditësit, A. M. nga fshati S., Komuna V., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura MBN, Mexhit Syla avokat nga P., kundër të paditurave, Korporata Energjetike e Kosovës (më tej KEK Sh.A), me seli në P., të cilën e përfaqëson me autorizim M. P., jurist për përfaqësime dhe K. e S. "E.", me seli në P., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit A.K., jurist, me objekt të kontestit kompensim dëmi, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurës së parë KEK Sh.A, me seli në P., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.2740/2020, të datës 16.12..2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 18.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar, revizioni i të paditurës KEK Sh.A, me seli në P., i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2740/2020, të datës 16.12..2023.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.471/2017, të datës 27.11.2019, në dispozitivin I të tij është aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit A. M. dhe është detyruar e paditura e dytë KS "E." me seli në P., që paditësit, për lëndimet e pësuar në aksidentin e datës 09.01.2017, në vendin e tij të punës për pjesën e përgjegjësisë së saj në shkallë

prej 80%, t'ia paguaj shumat si në vijim: Për kompensimin e dëmit jo-material në emër të dhimbjeve fizike, shumën prej 2,700.00 €; në emër të frikës së përjetuar, shumën prej 2,150.00 €; në emër të shëmtimit trupor, shumën prej 1,400.00 €; në emër të zvogëlimit të përgjithshëm të aktivitetit jetësor, shumën prej 3,500.00 €. Për kompensimin e dëmit material në emër të ndihmës dhe për kujdesit të huaj, shumën prej 350.00 €; në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 400.00 €; në emër të rehabilitimit fizioterapeutik, shumën prej 130.00 €; në emër të shpenzimeve të mjekimit, shumën prej 8.00 €, me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 08.10.2019, si ditë e dhënies së aktgjykimit, e deri në pagesën definitive, të cilat obligohet t'ia paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me detyrim. Në pikën II të dispozitivit është refuzuar pjesa e kërkesëpadisë përtej shumave të aprovuara sikurse në pikën I dhe atë në emër të dhimbjeve fizike shuma 500 €, për frikë shuma 4,000.00 €, për shëmtim trupor shuma 2,000.00 € dhe për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shuma prej 15,000.00 €, në emër të ndihmës së huaj shuma 400.00 €, në emër të rehabilitimit fiziko-terapeutik shuma 500.00 €, si të pabazuara. Në pikën III të dispozitivit është refuzuar kërkesëpadia e paditësit ndaj të paditurës KEK Sh.A. me seli në P., si e pabazuar. Në pikën IV të dispozitivit është detyruar e paditura KS''E.'' me seli në P., që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 2,278.00 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me detyrim''.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2740/2020, të datës 16.12..2023, në pikën I të dispozitivit, aprovohet ankesa e të paditurës K. e S. ''E.'' me seli në P., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.471/2017 i datës 27.11.2019, ashtu që çështja gjykohet si vijon: Pjesërisht aprovohet kërkesëpadia e paditësit A. M. nga fshati S., Komuna V., dhe obligohet e paditura KEK Sh.A, me seli në P., që paditësit A. M., në emër të kompensimit të dëmit jomaterial dhe material, si pasojë e lëndimit në punë me datë 09.01.2017, t'ia paguan në emër të dhimbjeve fizike, shumën prej 2,700.00€, frikës së përjetuar, shumën prej 2,150.00€, në emër të shëmtimit trupor, shumën prej 1,400.00 €, për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 10%, shumën prej 3,500.00€, në emër të ndihmës së personit të tretë, shumën prej 350.00 €, ushqimit të përforcuar shumën prej 400.00 €, në emër të rehabilitimit fizioterapeutik shumën prej 130.00 € si dhe shpenzimeve të mjekimit, shumën prej 8.00 €, të gjitha këto me kamatën ligjorë në shkallën prej 8% vjetor filluar nga data 08.10.2019 e deri në pagesën përfundimtare së bashku me shpenzimet e procedurës në lartësi prej 2,278.00€, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë nga shumat e kërkuara me precizim të padisë e gjerë në shumat e

gjykuara refuzohet, si e pabazuar. Në pikën II padia dhe kërkesëpadia e paditësit A. M. nga fshati S., Komuna V., kundër të paditurës K. e S. "E." me seli në P., refuzohet si e pabazuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor, e paditura e parë Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), me seli në P., ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësit si e pa bazuar.

Përgjigje në revizion nuk pati

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion, pretendimet e revizionit, si dhe shkresat e lëndës dhe gjeti se :

Revizioni i të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) me seli në P. është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se paditësi kundër të paditurës KEK Sh.A, më datë 03.03.2017, ka parashtruar padi për kompensimin e dëmit jo material dhe material si pasojë e lëndimit në vendin e punës më datë 09.01.2017. Gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore në shkallë të parë, paditësi e zgjeron padinë edhe kundrejt të paditurës, KS "E." me seli në P., nën pretendimet se KS "E." i detyrohet paditësit, për faktin se e njëjta ka lidhur kontratë për sigurimin shëndetësor të punësuarve të së paditurës së parë KEK Sh.A.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë dhe administruar provat, ku pas analizimit dhe vlerësimit të tyre, konkretisht mendimin e ekspertit nga fusha e sigurisë dhe mbrojtjes në punë, ekspertëve të fushës së mjekësisë respektive, pjesërisht e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke e detyruar të paditurën e dytë, KS "E." në kompensimin e dëmit jo material dhe atë material, duke vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, ndërsa e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit ndaj të paditurës KEK ShA. Për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadiës, gjykata e shkallës së parë sipas propozimit të palëve, në cilësinë e provës ka marrë mendimin e ekspertëve mjekësor ortoped - traumatolog, , neurokirurg , psikiatër, si dhe eksperti i mbrojtjes, përkritazi me natyrën, shkallën dhe pasojat e lëndimeve që ka pësuar paditësit si pasojë e aksidentit, si dhe përgjegjësinë për shkaktimin e aksidentit...

Në bazë të ekspertizave mjekësore të shqyrtuara, ka vendosur lidhur me lartësinë e kompensimit të dëmeve materiale dhe jo materiale duke u bazuar në dispozitën e neni 136, 137, 154, 169, 173, 183, dhe 918, 961, 962 dhe 963 të LMD-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar në pjesën e përgjegjësisë subjektive duke e obliguar të paditurën e parë, KEK Sh.A me seli në P. që t'ia kompensoi paditësit dëmin e shkaktuar në aksidentin, në vendin e punës, kurse e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit në drejtim të paditurës së dytë, KS "E.", me seli në P. .

Gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se në këtë çështje kontestimore gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale mbi gjendjen e fakteve dhe provave të çështjes, kur ka gjetur se e paditura KS 'E.', është përgjegjëse për kompensimin e të gjitha formave të dëmit të paditësit si pasoj e lëndimit në punë. Kjo gjykatë ka gjetur se përgjegjëse për kompensimin e dëmit të paditësit është e paditura e parë KEK Sh.A, me seli në P., për shkak se format e kompensimit të aprovuara nga gjykata e shkallës së parë, nuk përfshihen në kontratën kornizë nga e cila burën përgjegjësia për kompensimin e dëmit, konkretisht tek kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës për sigurimin shëndetësor që ka lidhur e paditura KEK ShA, me të paditurën KS "E." me datë 05.10.2015. Në rastin konkret mbulimi i rasteve nga fatkeqësia në punës- aksidentet në punë, sipas kushteve të veçanta të kontratës, mbulohen çështjet e kompensimit të shpenzimeve mjekësore dhe rastet e paaftësisë punuese nga aksidenti personal në shumën e caktuar të primit varësisht nga paaftësia, që në rastin e paditësit edhe pse si pasoj e lëndimit në punë ka pësuar lëndime të rënda trupore. Duke qenë se gjykata e shkallës së parë, sa i përket gjendjes faktike të çështjes, të njëjtën e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe mbi bazën e provave të pa kontestuara, gjykata ka gjetur se në këtë rast duhej ndryshuar aktgjykimi i atakuar vetëm përkitazi me subjektin detyrues, pra me legjitimitet real në raportin e detyrimit për kompensim.

Gjykata e Apelit e ka pranuar në tërësi pjesën e aktgjykimit të atakuar përkitazi me lartësinë e shumat të gjykuara dhe se në këtë pjesë pretendimet ankimore nuk qëndrojnë, andaj kolegji ka gjetur se gjykata e shkallës së parë përkitazi me dëmin jomaterial për dhimbje fizike, përjetimit të frikës, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimit drejtë ka

vërtetuar gjendjes faktike, mbi bazën e gjendjes së provave, ngase janë vërtetuar dhe përcaktuar shkalla, natyra, intensiteti, kohëzgjatja dhe pasojat e lëndimeve që ka pësuar paditësi si pasojë e aksidentit të datës 09.01.2017 dhe se ekspertët adekuat të fushës respektive të ortopedisë-traumatologjisë dhe psikiatrisë kanë dhënë mendimin e tyre profesional dhe objektiv.

Në kësi rrethanash faktike, Gjykata Supreme e Kosovës i ka vlerësuar si të pa bazuara thëniet e revizionit të paditëses se aktgjykimi i goditur është marrë me shkeljen thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara nga neni 182 par. 2 pika (n) të LPK, për faktin se të dy aktgjykimet e përmendura kanë dhënë arsye për faktet vendimtare të rëndësishme për gjykim të drejtë në këtë çështje juridike. Gjykata Supreme e Kosovës duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi, si të drejt dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë, nga se në gjendjen faktike të vërtetuar drejtë, drejtë janë aplikuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe e drejta materiale.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, i cili ishte atakuar me ankesë vetëm nga e paditura e dytë KS "E.", ka përmbajtje koherente dhe rrjedhë logjike, duke i arsyetuar të gjitha pretendimet ankimore dhe shkeljet që vlerësohen sipas detyrës zyrtare, lidhur me vlerësimin se aktgjykimi i shkallës së parë duhet ndryshuar dhe kërkesëpadia duhet refuzuar si e pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës e pranon konstatimin e gjykatës së shkallës së dytë kur ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë, gabimisht e ka vlerësuar se përgjegjëse për kompensimin e dëmit është e paditura e parë, KS "E." dhe me refuzimin e kërkesëpadisë, për të paditurën e parë KEK ShA, gjykata gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, sepse përgjegjëse për dëmet që i janë shkaktuar paditësit në vendin e punës, gjatë kryerjes së veprimtarisë që e ushtron pikërisht e paditura e parë, ndërsa që ekzistimi i policës së sigurimit nuk e përjashton atë nga përgjegjësia për dëmet e paditësit, e që pretendim ankimor edhe i të paditurës së dytë ka qenë se me policën e sigurimit të lidhur në mes të paditurës së parë dhe të paditurës së dytë është paraparë kompensimi i punëtorëve të së paditurës së parë në rast të aksidentit, si të shpenzimeve mjekësore dhe në raste të paaftësisë punuese shuma e caktuar

Gjykata Supreme e Kosovës e aprovon qëndrimin se nga kontrata publike-kornizë e shërbimeve numër, datë 05.10.2015, e lidhur në mes të paditurave, vërtetohet fakti së të paditurat kanë lidhur kontratën për sigurimin e punëtorëve të paditurës së parë, e cila ka qenë e vlefshme nga data 01.10.2015 e deri më datë 30.09.2017. Lëndë kësaj kontrate ka qenë që të themeloh kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e

shërbimeve të sigurimit për të punësuarit me kontratë pune, pa afat ose me afat më shumë së një muaj, që punojnë me kohë të plotë ose të pjesshme, të cilët do të sigurohen për sëmundje, shtatzënat, aksidentet në punë dhe sigurimin shëndetësor.

Gjykata e revizionit gjenë se, gjykata e shkallës së dytë i ka vlerësuar kushtet e veçanta në pjesën III të kontratës publike kornizë, për shërbimet e sigurimit shëndetësor për punëtorët e KEK-ut, të cilat janë në shkresa të lëndës, të cilat në mënyrë të saktë parashohin kushtet dhe pjesën e mbuluar nga kontrata për sigurimin shëndetësor dhe se këto shuma të gjykuara nuk përfshijnë kategoritë të cilat janë paraparë në kontratë prandaj edhe me të drejtë është aprovuar kërkesëpadia ndaj të paditurës së parë. Pra është edhe vlerësim i Gjykatës Supreme të Kosovës se për kategoritë e kompensimit të dëmit jo material si dhe për kategoritë e kompensimit të dëmit si pasojë e nevojës për ushqim të sforcuar dhe përkujdesje ndaj personit të tretë, përgjegjësia bie mbi të paditurën e parë sepse këto kompensime nuk janë parapa në kontratën e cekur më lartë. Për këtë arsye u refuzuar si të pa bazuara pretendimet e revizionit lidhur me përgjegjësinë e të paditurës KEK Sh.A.

E paditura e dytë nuk e ka kontestuar pjesën e përgjegjësisë së vet dhe ka paguar të gjitha shpenzimet e shërimit si dhe pjesën prej 80% të pagës për periudhën sa ka qenë në pushim mjekësor, ashtu siç parashihet në kontratë. Ndërsa nuk u aprovua pretendimi në revizion i të paditurës së parë, lidhur me ndarjen e përgjegjësisë për të cilën e paditura e parë, në revizion pretendon se nuk është proporcionale. Lidhur me këtë Gjykata e Supreme e Kosovës e aprovon qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë lidhur me ndarjen e përgjegjësisë 80% me 20%, dhe shumat e gjykuara janë në përputhje të plotë me ekspertizën e datës 09.05.2019, ku thuhet se përgjegjësia primare lidhur me rastin aksidental bie mbi të paditurën KEK ndërsa një pjesë e përgjegjësisë, bie mbi paditësin për shkak të lëshimit të zbatimit rigoroz të masave mbrojtëse. Në seancën e shqyrtimit të provave, më datën 09.09.2019, eksperti i mbrojtjes në punë H. H. pas administrimit të ekspertizës si provë, është përgjigjur në shqetësimet e palëve dhe se ekspertiza e tillë është pranuar pa vërejtje në seancën e administrimit të provave më 08.10.2019. Prandaj edhe kjo ndarje e përgjegjësisë sipas Gjykatës Supreme të Kosovës është e drejtë dhe e ligjshme dhe në këtë drejtim pretendimi i revizionit u refuzua si i pa bazuar.

Gjykata Supreme gjene se drejtë është vlerësuar dhe analizuar përgjegjësinë e të paditurës së dytë në raport me kushtet e veçanta të kontratës së lartpërmendur për sigurimin e punëtorëve, dhe në arsyetim janë dhënë fakte dhe prova bindëse për përgjegjësinë e të paditurës së parë për kompensimin e paditësit për lëndimin e pësuar në vendin e punës për kategoritë e

kompensimit të dëmit jo material. Prandaj Gjykata Supreme e Kosovës e aprovon qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë, lidhur me përgjegjësinë e të paditurës KEK Sh.A, si dhe faktin shumëat ishin në proporcion me të mirën e dëmtuar dhe me ato që zakonisht caktohen në situata të tilla,. Prandaj, pretendimet në revizion në drejtim të shumave të aprovuara, Gjykata Supreme i vlerëson si të pa themelta, dhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate, dhe konsideron se janë reale dhe në përputhje me kriteret e parapara ligjore si dhe në harmoni me praktikën gjyqësore.

U refuzuan edhe pretendimet tjera në revizion për të cilat Gjykata Supreme vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë ka dhënë arsyetime të qarta dhe të mjaftueshme lidhur me faktet juridikisht të vlefshme për gjykim të drejtë të kësaj çështjeje juridike, të cilat janë të pranueshme plotësisht edhe për gjykatën e revizionit, andaj duke mos qenë me relevancë, këto pretendime të revizionit u refuzuan si të pa bazuara.

Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga e paditura e parë nuk janë vlerësuar pasi që sipas dispozitës së nenit 214 paragraf 2, të LPK-së, përcaktohet se: “revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike”.

Për arsyet e paraqitura më lart, revizioni i të të paditurës së parë u refuzua si i pabazuar, andaj me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPRME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.101/2024, datë 18.03.2024

Kryetar i kolegjit,

Beshir Islami